



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 741 Akti

Nr. 459Vendimi
Tiranë, më 13.10.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Suela Zhegu	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 13.10.2021, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Elona Shehu**, ndihmëse ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, zj. Elona Shehu, gjatë periudhës së rivlerësimit ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Në zbatim të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit më 15.6.2021, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, Elona Shehu, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët: Olsi Komici, Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes me short u zgjodh komisioneri Suela Zhegu.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK).

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 25.6.2021, vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 8.9.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua nëpërmjet postës elektronike mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe për përbërjen e trupit gjykues për të cilën deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me asnjë nga anëtarët e tij.

6. Në datën 14.9.2021, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin, përmes postës elektronike, se nuk duhet t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, pasi nuk bën pjesë në kategorinë e subjekteve të rivlerësimit të përcaktuar në nenin 179/b të Kushtetutës. Gjithashtu, subjekti informon se nuk ushtron më funksionin e ndihmësës ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme që prej datës 7.12.2017, bazuar në urdhrin nr. 267, datë 7.12.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për emërimin e oficerit të policisë gjyqësore”.

7. Komisioni, me shkresën e datës 24.9.2021¹, i ka kërkuar Prokurorisë së Përgjithshme të vendosë në dispozicion të Komisionit kopjen e plotë të dosjes së personelit që i përket subjektit Elona Shehu.

8. Në datën 27.9.2021, në Komision është regjistruar kërkesa² e subjektit të rivlerësimit Elona Shehu, adresuar edhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, duke kërkuar pranimin e vullnetit të saj për t'u dorëhequr sipas parashikimit në nenin G të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti ka informuar se nuk ushtron detyrën e “ndihmësës ligjor” dhe, për rrjedhojë, për arsye formale, ka paraqitur kërkesën për dorëheqje dhe kërkon ndërprerje të procesit të rivlerësimit, duke u përjashtuar nga mundësia e emërimit në organet e drejtësisë sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

9. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 1.10.2021, ka dërguar dokumentacion mbi dosjen personale të znj. Elona Shehu, e cila është emëruar në detyrën e ndihmësës ligjore me urdhrin nr. ***, datë 12.5.2014, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në datën 7.12.2017, pasi është emëruar oficer e policisë gjyqësore.

Aktualisht znj. Elona Shehu ushtron funksionin e oficerit të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

10. Në datën 1.10.2021, Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 1.10.2021, ka vendosur në dispozicion, ndër të tjera:

- Urdhrin nr. ***, datë 7.12.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm për emërimin e znj. Elona Shehu oficer e policisë gjyqësore në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme. Në këtë urdhër është vendosur fillimi i marrëdhënieve financiare në datën 7.12.2017.

- Urdhrin nr. **, datë 23.1.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm për transferimin e oficerit të policisë gjyqësore në të njëjtën detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹Shkresa nr. *** prot., datë 24.9.2021, e Komisionit.

²Regjistruar me nr. *** prot., datë 27.9.2021, në Komision.

- Vendimin nr. **, datë 13.3.2021, të Komisionit të Policisë Gjyqësore për transferimin e oficerit të policisë gjyqësore në të njëjtën detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

11. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar në respektim të pikës 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

12. Në lidhje me pretendimin e subjektit për të mos iu nënshtuar procesit të rivlerësimit, pasi nuk bën pjesë në kategorinë e subjekteve të rivlerësimit të përcaktuar në nenin 179/b të Kushtetutës, Komisioni argumenton se ky pretendim i subjektit nuk qëndron për faktin se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti ka qenë në detyrën e ndihmësit ligjor deri në datën 7.12.2017 dhe qenia në këtë funksion si “ndihmës ligjor”, sipas përcaktimit kushtetues janë subjekte të rivlerësimit *ex officio*, bazuar në paragrafin 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës.

13. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara më lart, konstaton se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e ndihmësit ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Prokurori i Përgjithshëm, me Urdhrin nr. ***, datë 7.12.2017, ka vendosur emërimin e subjektit oficer të policisë gjyqësore, duke sjellë për rrjedhojë humbjen e statusit të ndihmësit ligjor.
- iii. Subjekti i rivlerësimit Elona Shehu ka paraqitur kërkesë për dorëheqje pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, për shkak të mosushtimit më të detyrës së ndihmësit ligjor.

14. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”*.

15. Neni 56 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon:

“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.

2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit ‘Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit’”.

16. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: *“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë*

rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”.

17. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në rrugë elektronike, më 8.10.2021 ka njoftuar subjektin nëse ka vullnetin të marrë pjesë në seancë dëgjimore dhe se fokusi i kësaj seance do të jetë ndërprerja e procesit të rivlerësimit në zbatim të paragrafëve 1 dhe 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

18. Subjekti i rivlerësimit, më 11.10.2021, me anë të postës elektronike, ka njoftuar Komisionin se nuk dëshiron të marrë pjesë në seancë dëgjimore, duke vlerësuar faktin se tashmë ka shprehur qëndrimin e saj ndaj ecurisë së këtij procesi.

19. Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji për dorëheqje, duke marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

20. Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, atëherë pasoja juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës do të duhet të zbatohet në tërësinë e saj, duke i kufizuar të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.

21. Ky është një qëndrim i unifikuar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në vendimmarrje të mëparshme, sipas të cilave orientohet Komisioni që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit sipas pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

22. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për znj. Elona Shehu.
2. Ndalimin e emërimit të znj. Elona Shehu si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 13.10.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Suela ZHEGU
Relatore

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha